



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK**

Nr.1396/2 Prot.

Tiranë më 21.11.2018

**VENDIM**

**Nr.34, datë 21.11.2018**

***“Mbi hapjen e kurseve të gjuhëve të huaja nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja”***

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 38 pika 3; neni 91 pika 3; në Statutin e UT neni 19 pika 6; në Udhëzimin Nr 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, neni 4; si dhe në propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e tij të datës 21.11..2018,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për hapjen e kurseve ekstrakurrikulare në gjuhët e huaja dhe nivelet, si më poshtë:
  1. Gjuhë spanjolle, Niveli A1, A2, B1 dhe B2
  2. Gjuhë italiane, Niveli A1, A2, B1, B2, C1 dhe C2
  3. Gjuhë gjermane, Niveli A1, A2, B1, B2 dhe C1
  4. Gjuhë franceze, Niveli A1.1, A1.2, A2.1, A2.2, B1 dhe B2
  5. Gjuhë angleze, Niveli A1.1, A1.2, A2, B1, B2.1, B2.2, C1 dhe C2
  6. Gjuhë ruse Niveli A1 dhe A2
  7. Gjuhë greke Niveli A1 dhe A2
  8. Gjuhë turke Niveli A1 dhe A2
  9. Gjuhë hebreje Niveli A1 dhe A2
  10. Gjuhë polake Niveli A1 dhe A2
- II. Të miratojë formën e certifikatës bashkëngjitur këtij vendimi.
- III. Ti propozojë për miratim Bordit të Administrimit, planin financiar për secilin kurs
- IV. Ky vendim i përcillet QSHA-së për regjistrimin e formës së certifikatës në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**PROF.DR. MYNYR KONI**